Autoriteti/Enti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkesë nga Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korrigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor gjatë vlerësimit të

ofertave.

18. Përgjegjshmëria e ofertave

1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;
- (b) "**Rezervim**" është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe
- (c) "**Mospranim**" është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

F. VLERËSIMI I OFERTAVE

19. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik

1. Për një pjesë të kriterëve të pranimi të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklarate, ku shprehet se Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. Operatori ekonomik mund të përdorë një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret për të cilat nuk lejohet vetëdeklarim.

Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të

verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

20. Konvertimi në valutë të vetme

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

21. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 ____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = Ok1 \times Pmaxk1 / Vmax k1$$

Vmaxk1 ____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

Pmaxk1 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 ____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, autoritetet/entet kontraktore mund të përdorin kriteret e vlerësimit, si më poshtë:

Propozimi Teknik do të ketë 80 pikë

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) Përvoja për Punë të Ngjashme të operatorit ekonomik

Nënkriteret⁴

i/a Përvoja për punë të ngjashme

Operatorët ekonomikë, mund të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë

Operatorët ekonomikë mund të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

(ii) Metodologjia e Propozuar

Nënkriteret

ii/a. Përjasja teknike dhe metodologjia

⁴ Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit nënkritereve.

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit

ii.c. Organizimi i Stafit

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Operatori ekonomik duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve, të paraqesin problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojnë për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, duhet të shpjegohet metodologjia që propozojnë të adoptojë dhe të paraqesin kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar, duke mos përsëritur/kopjuar Termat e Referencës

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Operatori ekonomik duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret.

ii/c. Organizimi dhe Stafi: Operatori ekonomik duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e stafit të tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomik-administrativ.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm

b. Eksperienca në fushën përkatëse

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

2. Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHËNIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në

përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim

për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën

mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*)

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)***Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Loti I me objekt: “Blerje siguracioni për sigurimin e shëndetit të studentit specialist të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”

Sigurimi i shëndetit të studentit specialist gjatë periudhës së specializimit dhe ushtrimit të detyrave të parashikuara në programin specializues të organizuar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Shuma e sigurimit: mbrojtje deri 1,000,000 lekë për person

Afati kohor - 1 vit kalendarik

Numri i të siguruarve - Pasqyruar në tabelë dhe mund të ndryshojë me lëvizjen e specialistëve.

Pozicioni i punës - Specializante

- Kërkohet edhe primi ditor me të njëjtat limite përgjegjësie.

Përkufizime.

“Aksident ose Aksidental/e” do të kuptohet një ngjarje e menjëhershme, e papritur dhe e paparashikueshme që ndodh rastësisht dhe e paqëllimshme, ngjarje e cila ka impakt trupor të drejtpërdrejtë, të jashtëm dhe të dhunshëm mbi specialistin që do të sigurohet, që rezulton me humbjen e jetës ose paaftësi të specialistit që do të sigurohet, brenda 12 muajsh nga data e ngjarjes.

“Dëmtimi trupor aksidental/e” do të kuptohet dëmtimi trupor i specialistit nga një aksident që ndodh brenda periudhës së sigurimit, i shkaktuar vetëm dhe drejtpërdrejtë nga shkaqe aksidentale dhe që brenda 12 muajsh nga data e këtij aksidenti rezulton në humbjen e jetës, dëmtimin trupor ose paaftësi për punën e specialistit.

“Aksident në punë ose për shkak të punës” është dëmtimi i menjëhershëm trupor, i ndodhur gjatë kryerjes së punës ose gjatë një procesi i cili ka lidhje me punën, si dhe çdo dëmtim tjetër i shëndetit, që sjell paaftësi të përkohshme ose të përhershme në punë ose vdekje. Aksidenti vlerësohet se ka ndodhur në punë ose për shkak të punës, kur specialisti dëmtohet:

- a) gjatë kryerjes së punës së zakonshme;
- b) gjatë kryerjes së një pune tjetër, pa urdhër të punëdhënësit, por për arsye madhore në interes të punës;
- c) gjatë kryerjes së një pune tjetër, me porosi të punëdhënësit;
- d) gjatë kohës së pushimit, në vendin e caktuar ose për vënien në rregull të makinerive, veglave të punës, veshmbathjeve, para ose pas mbarimit të punës;
- e) gjatë rrugës, në linjën e drejtpërdrejtë, nga banesa për në punë dhe anasjelltas;
- f) në rastet kur transporti është i organizuar nga punëdhënësit dhe kur ai është individual;

“Përfitim” do të kuptohet shuma e përfitimit në tabelën e përfitimeve për kategorinë përkatëse të humbjes, e pagueshme nga Siguruesi sipas kushteve të kësaj policie.

“Fillimi i sigurimit” do të thotë periudha kohore e policës e përcaktuar, në bazë të të cilave kjo policë është operative.

“Datë efektive” do të cilësohet data kur polica do të mbulojë çdo specialist të siguruar.

“Person i Siguruar” do të thotë specializant pranë Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare, i cili është përfshirë në këtë policë, ose çdo ndryshim të kësaj police, që në ditën e parë të “Datës Efektive”.

“Humbje gjymtyre” do të thotë, humbja dhe shpëputja fizike e një dore nga kyçi ose një këmbë nga nyja dhe që përfshin humbjen e plotë dhe të pakthyeshme të përdorimit të një dore, krahu ose këmbë.

“I/e përhershëm/e” do të lidhet me paaftësinë që zgjat në afat kohor mbi 12 muaj dhe në përfundim të tyre nuk ka shpresë përmirësimi.

“Paaftësi e pjesshme e përhershme” do të thotë humbje e aftësisë për punë e specializantit, e shkaktuar nga një aksident i cili do të rezultojë:

- a) me humbje të plotë anatomike,
- b) me humbje të përhershme funksionale të një ose disa organeve ose gjymtyrëve të specializantit, siç përcaktohet në ‘Tabelën e Përfitimeve’.

“Paaftësi e plotë e përhershme” do të thotë paaftësi që zgjat të paktën 12 muaj të njëpasnjëshëm dhe e cila e ndalon plotësisht specializantin të ndërmarrë çdo lloj punësimi për të cilin ai është i aftë nga arsimi, trajnimi apo përvoja, për të gjithë jetën kur nuk ka shpresë përmirësimi.

“Policëmbajtës” do të thotë Autoriteti Kontraktor i identifikuar si i tillë në formular si edhe student i cili do të disponojë policën në momentin e lidhjes së saj.

“Policë” do të thotë marrëveshja e nënshkruar nga palët, të cilat së bashku përbëjnë të gjithë policën.

“Shumë sigurimi:” do të thotë shuma maksimale e përfitimit, e pagueshme për specializantin që është siguruar. (specializanti që sipas kësaj police lidhet me:

- a) dëmtimin trupor;
- b) paaftësinë aksidentale të personit të siguruar.

“Paaftësi e pjesshme e përkohshme” do të thotë, humbje e pjesshme e përkohshme e aftësisë së specializantit për të punuar ushtruar detyrat, shkaktuar nga një aksident që rezulton me dëmtim trupor, i cili e ndalon përkohësisht specializantin që të ndërmarrë çdo punësim, ushtrim detyre për të cilin është i aftë nga arsimi, trajnimi ose përvoja (ose nëse nuk është i punësuar çdo lloj punësimi të pagueshëm).

“Paaftësi e plotë e përkohshme” do të thotë humbje e përkohshme e aftësisë së specializantit për të punuar, ushtruar detyrat, shkaktuar nga një aksident që rezulton në dëmtim trupor të specializantit, e që e ndalon përkohësisht specializantin që të ndërmarrë çdo lloj punësimi për të cilin ai është i aftë nga arsimi, trajnimi apo përvoja (ose nëse nuk është i punësuar çdo lloj punësimi të pagueshëm).

1. Afati kohor

Afati kohor i policës do të jetë 1 vit kalendarik për studentët në vazhdimësi dhe për studentët që e kanë të përcaktuar afatin e përfundimit të studimeve, kontrata do lidhet bazuar në këto afate kohore (Përcaktuar te numëri i studentëve).

*** Në rast se një specialist ndërpren studimet, për atë specialist, të bëhet kthim primi për pjesën e mbetur, pa pretenduar mbajtje për shpenzime administrative, por vetëm llogaritjen në bazë ditore të shfrytëzimit të policës, nëse ky Specialist nuk ka përfituar nga kjo policë.**

2. Fillimi dhe përfundimi i mbulimit të sigurimit

2.1 Mbulimi në sigurim për sa i përket çdo specialisti të siguruar, do të fillojë në Datën Efektive dhe do të përfundojë me ndodhjen e më të hershmes prej ngjarjeve vijuese:

- Kur kjo policë përfundon në përputhje me afatin e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit dhe policës së sigurimit;
- Data në të cilën specialisti i siguruar pushon së qeni i tillë pranë Fakultetit të Mjekësisë Tiranë dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare
- Data e përfundimit e vendosur në Formular.
- Përfshirja dhe heqja automatike nga mbulimi në sigurim

2.2 Kjo policë do të mbulojë automatikisht me sigurim, të gjithë specialistet e siguruar si dhe të gjithë specialistet e rinj, prej datës së fillimit të punës në varësi të njoftimit të dhënë Siguruesit nga Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare.

Mbulimi përfundon në datën e përfundimit të sigurimit ose të specializimit.

3. Përfitimet nga ky sigurim

Në vartësi të parashikimeve, kushteve e përjashtimeve të Policës së Sigurimit, me marrjen dhe miratimin e provës, Siguruesi do t'i paguajë specialistit të siguruar/ përfitimin:

- Përfitimi në rast paaftësie të plotë të përhershme aksidentale**
Nëse gjatë periudhës që kjo Policë është në fuqi, i Siguruari pëson Dëmtim Trupor Aksidental me pasojë Paaftësinë e përhershme të plotë ose të pjesshme të përshkruara në Tabelën e Përfitimeve, atëherë Operatori Ekonomik me të cilin do të lidhet kontrata e sigurimit të aksidenteve në punë, me marrjen dhe miratimin e provave të nevojshme, do të paguajë shumën përkatëse të përfitimit sipas Tabelës së Përfitimeve.
- Përfitimi në rast paaftësie aksidentale të pjesshme të përhershme/të përkohshme**
Nëse gjatë periudhës që kjo Policë është në fuqi, i Siguruari pëson Dëmtim Trupor Aksidental me pasojë Paaftësinë e përkohshme, Operatori Ekonomik me të cilin lidhet kontrata e sigurimit të aksidenteve në punë, me marrjen dhe miratimin e provave të nevojshme, do të paguajë një përfitim sipas tabelës së përfitimeve në vijim:

Tabela e Përfitimeve

(në % ndaj shumës së siguruara)

	djathtë	majtë
a) Paaftësi e pjesshme e përhershme		
b) Humbje totale anatomike dhe funksionale e:		
• Gjymtyrës së sipërme mbi brryl	70	60
• Një dorë ose parakrahu	60	50
• Bllokimi i plotë i kyçit të dorës	40	30
• Gishtit të madh të dorës	18	16
• Gishtit tregues të dorës	14	12
• Gishtërinjë të tjerë të dorës	8	6

• Gishtit të vogël të dorës ose një gisht i këmbës	12	10
• Një falangë të gishtit të madh të dorës	9	8
• Një falangë të gishtave të tjerë të dorës	1/3 e gishtit	
• Një këmbë mbi gju		60
• Një këmbë poshtë gjurit		50
• Bllokimi i plotë i kofshës deri në mes		40
• Bllokimi i plotë i përdorimit të këmbës në nivel të nyjes		30
• Gishtit të madh të këmbës		5
• Çdo gisht tjetër të këmbës		3
• Një falangë të gishtit të madh të këmbës		2.5
• Një falangë të gishtave të tjerë të këmbës		1
• Humbje e plotë dhe e pakthyeshme e shikimit të një syri		50
• Humbje e plotë dhe e pakthyeshme e dëgjimit të një veshi		10
• Humbje e plotë dhe e pakthyeshme e dëgjimit të dy veshëve		40
• Shpretkës		10
• Një veshke		30
d. Paaftësi e plotë e përhershme		
• Humbje e plotë dhe pakthyeshme e shikimit të dy syve	100	
• Humbje e plotë fizike dhe funksionale e dy ose më shumë gjymtyrëve së bashku		100
• Sëmundje mendore e plotë dhe e pakurueshme	100	
• Paralizë e plotë dhe e pakurueshme	100	
• Paaftësi e plotë e përhershme	100	
e. Paaftësi e plotë e përkohshme (për javë)		0.5
f. Paaftësi e pjesshme e përkohshme (për javë)		0.15

4. Policëmbajtësi

3.1 Në policën e sigurimit **policëmbajtës** do të jetë specialisti.

3.2 Polica e sigurimit do të jetë individuale, e hartuar në 3(tre) kopje.

3.3 Lista e studentëve specialistë duhet të jetë e firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria e Sigurimit si dhe duhet të përmbajë të dhëna të domosdoshme për çdo specialist si : emër, mbiemër, atësia, nr.ID, dega e specializimit, viti i studimit, data e mbarimit të specializimit, data e fillimit dhe mbarimit të sigurimit, shuma e sigurimit, monedha, nr.ditëve të siguruara, primi ditor dhe total ..etj.

3.4 Lista emërore e specializanteve, do t'i vihet në dispozicion operatorit ekonomik i shpallur fitues.

3.5 Me përfundimin e polices:

a) Polica nuk ka vlerë;

b) Mbulimi në sigurim i dhënë nga kjo policë merr fund.

5. Kushtet e përgjithshme të sigurimit

Kushtet e përgjithshme të sigurimit do të jenë të bazuara në kodin civil, ligjin 52/2014 për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit dhe udhëzimet e nxjerra nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën që të sigurojë përveç specialistëve që janë aktualisht në momentin e lidhjes së kontratës edhe specialistët e tjerë që do të fitojnë konkursin për vitin akademik në vazhdim.

Në momentin e lidhjes së kontratës do të bëhet sigurimi i të gjithë studentëve specializantë pranë Autoritetit Kontraktor. Nëse pas kësaj date Autoritetit Kontraktor do të pranojë persona të tjerë, Kontraktuesi ka detyrimin që brenda fondit limit total të ofertës fituese të bëjë sigurimin e këtyre personave. Në këtë rast, Kontraktuesi ka detyrimin që primin e sigurimit për personat e siguruar rishtazi ta llogarisë në përpjestim me periudhën e mbetur të sigurimit sipas afatit të kontratës dhe primit ditor përcaktuar në Formularin e Ofertës. Autoriteti Kontraktor do të njoftojë menjëherë me shkrim Kontraktuesin për cdo specializant të ri që dot'i shtohet në skemën e sigurimit.

Periudha e sigurimit do të fillojë në datën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor e cila paraqitet në formë të shkruar.

6. Kushte të veçanta

Siguruesi paguan përfitimin për pasojat e drejtpërdrejta dhe ekskluzive të shkaktuara nga aksidenti. Në rast humbje anatomike ose reduktim të funksionit të një organi ose gjymtyrë të dëmtuar, e cila ka qënë dëmtuar para ndodhjes së aksidentit, përqindjet e mësipërme do të zvogëlohen duke marrë parasysh paaftësinë e mësipërme. Llogaritja do të jetë zbritja e thjeshtë aritmetike ndërmjet përqindjes së paaftësisë aktuale dhe përqindjes së paaftësisë së mëparshme.

Në rast se rrjedhë e aksidentit është reduktimi, por jo humbja e plotë e funksionit ose gjymtyrës, për sa i përket përcaktimeve të tabelës së mësipërme përqindjet e mësipërme do të zvogëlohen përpjesëshmërisht me shkallën e humbjes anatomike apo funksionale. Llogaritja kryhet në mënyrë të ngjashme me paragrafin e mësipërm.

Nëse pasojat e aksidentit do të rëndohen nga ndonjë gjendje ose paaftësi fizike e specializantit të siguruar, e cila ka ekzistuar para ndodhjes së aksidentit, atëherë shuma e çdo përfitimi të pagueshëm do të jetë shuma që konsiderohet në mënyrë të arsyeshme që do të ishte paguar në rast se kjo pasojë nuk do të ishte rënduar në këtë mënyrë.

Në rast se specializanti i Siguruar është mëngjerash përqindja e përfitimit (nën treguesit 'djathtë' ose 'majtë') do të shkëmbehen në mënyrë që përqindja më e lartë e përfitimit të zbatohet për dorën/këmbën e majtë dhe pjesët e tyre.

Siguruesi ka të drejtë absolute të përcaktojë përqindjen e pagueshme për çdo paaftësi të përhershme që nuk është përcaktuar në Tabelën e Përfitimeve.

Në rast se specializanti i Siguruar pëson disa humbje të ndryshme anatomike ose funksionale (që nuk përfshijnë njëra-tjetrën), përfitimi total i pagueshëm do të duhet të jetë i barabartë me shumën e përqindjeve të paaftësisë së çdo humbje, por jo më shumë se 100% e shumës së sigurimit.

7. Mbulim shtesë

Mbytja në ujë dhe nga gazi e tymi helmues.

Ndërsa kjo policë është në fuqi, në rast se specializanti i Siguruar humbet jetën ose pëson paaftësi të plotë të përhershme si rrjedhë e mbytjes në ujë ose nga gazi e tymi helmues, do të paguhet shuma përkatëse e përfitimit e përcaktuar në Tabelën e Përfitimeve, me kusht që ky dëmtim të mos jetë pasojë e veprimeve të qëllimshme të specializantit të Siguruar.

8. Përfundime

Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës të paguajë për dëmtime/humbje që janë pasojë direkte ose indirekte

- a) Luftës, pushtimit, veprime të armikut të jashtëm, luftimeve (pavarësisht nëse është deklaruar luftë ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, revoltës, kryengritjes.
 - b) Reaktorit bërthamor, rrezatimit bërthamor ose ndotjes radioaktive, pavarësisht nga burimi i tyre.
 - c) Ekspozimit të qëllimshëm të Personit të Siguruar ndaj rreziqeve të larta (përveçse në përpjekje për të shpëtuar jetë njerëzore) ose veprimeve kriminale të vetë Personit të Siguruar.
 - d) Dehje, përdorim të tepruar të lëndëve psikofarmaceutike, drogave dhe halucinantëve.
 - e) Vetëvrasje ose tentativë për vetëvrasje.
 - f) Dëmtime trupore të vetëshkaktuara.
 - g) Pjesëmarrje në sporte të rrezikshme si parashutimi, alpinizmi, fluturimi me avion pa motor, zhytje nënujore, gara motorrike.
 - h) Pjesëmarrjes së të sigurvearit në fluturime, përveçse si pasagjer në një avion të licencuar që i përket një shoqërie ajrore.
 - i) Pjesëmarrjes e të sigurvearit në veprimtari kriminale, sulme apo veprime e kundërveprime të dhunshme.
 - j) Defekteve mendore ose fizike të të sigurvearit që ekziston para fillimit të kësaj police, përveçse kur siguruesi është informuar dhe i ka pranuar me shkrim.
- **Primi, duhet paguar brenda datës së përcaktuar në Formular. Kjo policë do të jetë e papaguar nëse primi përkatës nuk është pagur brenda datës së përcaktuar. Siguruesi lejon një periudhë 10 ditore nga data e përcaktuar për pagesë, policia qëndron në fuqi gjatë periudhës së lejuar. Nëse primi nuk paguhet deri në fund të periudhës së lejuar atëherë policia përfundon prej datës së paracaktuar për pagesën e primit që nuk është paguar.**

9. Procedurat e kërkesave për dëmshpërblim / përfitim:

a) Njoftimi i ngjarjes

Çdo ngjarje ose humbje që mund të rezultojë në një kërkesë për dëmshpërblim/përfitim do të duhet t'i raportohet me shkrim brenda 3 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes ose humbjes duke specifikuar rrethanat dhe pasojat.

Nëse njoftimi nuk jepet brenda kësaj periudhe kohore atëherë kjo do të zhvlerësojë kërkesën për dëmshpërblim/përfitim nëse do të provohet se nuk ka qenë e mundur në mënyrë të arsyeshme të jepej ky njoftim dhe ky njoftim është dhënë sapo ka qenë e mundur.

Në rastet e një aksidenti gjatë ushtrimit të detyres ose në funksion të kryerjes së detyres, me pasojë vdekje apo dëmtime të rënda masive, punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, pas dhënies së ndihmës së parë, duhet të ruajë provat materiale, për analizën e këtij aksidenti, dhe të

lajmërojë menjëherë organet e Prokurorisë, Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Siguruesin.

Kur aksidenti ka ndodhur gjatë rrugës nga banesa për në punë dhe anasjelltas, procesverbali i mbajtur nga organet e policisë, duhet të bëhet pjesë e dokumentacionit, për përfitimin e pagesës së aksidentit në punë.

Aksidenti gjatë ushtrimit të detyres ose në funksion të kryerjes së detyres vërtetohet me procesverbalin e mbajtjes në vendin e ngjarjes dhe duhet të nënshkruhet nga punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, si dhe nga përfaqësuesi i Siguruesit.

b) Prova e dëmtimit/humbjes

Prova me shkrim e dëmtimit/humbjes duhet t'i jepet Siguruesit sa më shpejt të jetë e mundur, brenda 30 ditësh nga njoftimi dëmtimit/humbjes, së bashku me kopjet origjinale të të gjithë dokumentacionit përkatës.

Personi i siguruar ose policëmbajtësi, me shpenzimet e tij, do t'i dorëzojë siguruesit në formën e kërkuar prej tij ato certifikata, informacione dhe të dhëna që siguruesi do të kërkojë.

Siguruesi do të ketë të drejtën por jo detyrimin që me shpenzimet e tij, t'i kërkojë personit të siguruar të kryejë kontrollin mjekësor sa herë të jetë e nevojshme gjatë periudhës së trajtimit të një kërkesë për dëmshpërblim/përfitim.

c) Pagesa e dëmshpërblimit/përfitimit

Siguruesi do të trajtojë policëmbajtësit (Specializant i siguruar) si përfituesit ligjor të kësaj police, çdo shumë e pagueshme sipas kësaj police do të paguhet me kërkesë të policëmbajtësit.

10. Kërkesa për dëmshpërblim/përfitim mashtrues

Nëse ndonjë kërkesë për dëmshpërblim/përfitim sipas kësaj police do të ketë ndonjë aspekt mashtrimi ose nëse policëmbajtësi, studenti specializant i Siguruar apo çdokush që vepron në emër të tyre do të përdorë mjete mashtrimi, atëherë siguruesi nuk do të ketë përgjegjësi për kërkesa të tilla.

11. Parashikime të tjera

- a) Kufijtë gjeografikë, përcaktojnë mbulimin me siguri të këtij siguri, e vlefshme për territorin Shqiptar.
- b) Plotësimi i kushteve të Sigurimit – Në rast se nuk plotësohet ndonjë nga kushtet e kësaj police, atëherë të gjithë kërkesat për dëmshpërblim/përfitim do të bëhen të pavlefshme.
- c) Përfundimi – Policëmbajtësi dhe siguruesi mund të përfundojnë këtë policë duke dhënë njoftim paraprak me shkrim të paktën 30 ditë më parë. Polica do të konsiderohet e anuluar me përfundimin e 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi.
- d) Juridiksioni – Çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Siguri që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim të dyanshëm do të jetë subjekt i legjislacionit Shqiptar dhe Gjykatës së Rrethit Tiranë.

12. Kthimi i Polices

- Ne rast se kerkohet nga Autoriteti Kontraktor per shkaqe të ndryshme.
- Nuk do te llogariten shpenzime administrimi
- Mbajta e primit per policen e sigurimit të perdorur, do te jete me baze 1 mujore.

Lista emërore e specialistëve, do t'i vihet në dispozicion operatorit ekonomik i shpallur fitues.

Specializantët pas lidhjes së kontratës do kenë policën e sigurimit individuale.

Nr.	PERSHKRIMI SHERBIMIT	I	Njesia	Nr. Dite për t'u siguruar	Institucioni
1	Siguracion i shëndetit për studentin specializant gjatë ushtrimit të detyrës Mbrotjtje deri 1,000,000 lekë		<i>Studentet specializante</i>	365	<i>Fakulteti Mjekësisë, Tiranë Fakulteti Mjekësisë Dentare</i>

- Limitet e përgjegjësisë së çdo specialist do të jenë:
- Sigurimi i shëndetit për specialist, mbulimi deri 1,000,000 lekë.
- Kërkohet edhe primi ditor me të njëjtat limite përgjegjësie.

Loti II me objekt: “Blerje siguracioni për sigurimin e përgjegjësisë profesionale të studentit specialist të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”

Sigurimi i Përgjegjësisë Profesionale gjatë periudhës së specializimit dhe ushtrimit të detyrave të parashikuara në programin specialistues të organizuar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Shuma e sigurimit: mbrotjtje deri 5,000,000 lekë për person

Afati kohor - 1 vit kalendarik

Numri i të siguruarve - Pasqyruar në tabelë dhe mund të ndryshojë me lëvizjen e specialistëve.

Pozicioni i punës – specialist

1. Mbulimi i Përgjegjësisë Profesionale të studentit (specializant)

Mbulimi i Përgjegjësisë Profesionale të studentit specialist, për dëmtime që ai mund t'i shkaktojë palëve të treta gjatë periudhës së specializimit dhe ushtrimit të detyrave të parashikuara në programin specialistues të organizuar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë .

2. Çdo kërkesë për dëmshpërblimin e palës së tretë gjatë periudhës së specializimit dhe ushtrimit të detyrave të parashikuara duhet:

- Të bëhet për dëme dhe me qëllim marrjen e kompensimit, si dhe shpenzimet e mbrotjtjes së miratuara nga i Siguruari;

- ii. Të jetë ngritur kundrejt të Siguruarit gjatë afatit të policës së sigurimit;
- iii. Të bëhet për dëme të mirëfillta financiare, që rrjedhin nga një veprim, gabim ose mosveprim, si pasojë e neglizhencës, të kryer nga i Siguruari gjatë afatit të sigurimit;
- iv. Të ketë ndodhur në rrjedhën e përmbushjes së zakonshme të shërbimeve profesionale nga i Siguruari, ose nga çdo person tjetër, që vepron në emër të tij me cilësinë e avokatit/juristit;
- v. Të ketë lidhje me një veprim, gabim ose mosveprim, si pasojë e neglizhencës, që ka ndodhur, ose mund të ketë ndodhur pas datës prapavepruese të përcaktuar në formularin e policës.

3. Procedurat e kërkesave për dëmshpërblim / përfitim:

- Njoftimi i ngjarjes
- Çdo ngjarje ose humbje që mund të rezultojë në një kërkesë për dëmshpërblim/përfitim do të duhet t'i raportohet me shkrim brenda 3 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes duke specifikuar rrethanat dhe pasojat.
- Nëse njoftimi nuk jepet brenda kësaj periudhe kohore atëherë kjo do të zhvlerësojë kërkesën për dëmshpërblim/përfitim nëse do të provohet se nuk ka qenë e mundur në mënyrë të arsyeshme të jepej ky njoftim dhe se ky është dhënë sapo ka qenë e mundur.

